



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorëzuar Priljet / Prodato Received / Delivroy	17-05-2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot (i) Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	4322/2023		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.714/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.714/2023 të datës 08.05.2023 të parashtruar nga ankuesi . me adresë rruga kundër Vendimit të datës 03.05.2023 të Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 17.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i inicuar sipas ankesës me numër A.nr.714/2023 të datës 08.05.2023, të parashtruar nga ankuesi .

A r s y e t i m

Komuna e Prishtinës më datë 24.03.2023 ka shpallur konkursin me Nr. reference: RN00011296 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor, ku afati për aplikim ka qenë nga data 08.04.2023 deri më datë 15.04.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi të cilit sipas Vendimit të datës 19.04.2023 i është refuzuar aplikacioni për shkak që nuk ka plotësuar kushtet e konkursit. Më datë 24.04.2023 ankuesi kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë në Sektorin e Burimeve Njerëzore, ndërsa u.d. Menaxheri i Personelit i Komunës së Prishtinës më datë 03.05.2023 ka nxjerr Vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesja më datë 08.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4131/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.





Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Prishtinës.

Ankuesi më datë 16.05.2023 përmes emailit [ankesa.kpmsnck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmsnck@rks-gov.net), ka parashtruar kërkesë me të cilën ka bërë tërheqjen e ankesës së datës 08.05.2023 të parashtruar ndaj procedurës së konkursit për pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për procedimi administrativ të filluar me ankesën e ankuesit, *sepse*:

Ankuesi më datë 08.05.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 4131/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet kundër Konkursin me Nr. reference: RN00011296 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën *Zyrtar i Lartë Ligjor* të datës 24.03.2023 të shpallur nga Komuna e Prishtinës, mirëpo ankuesi më datë 16.05.2023 ka parashtruar kërkesë me të cilën është deklaruar se tërhiqet nga ankesa e paraqitur në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në këtë Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës së datës 16.05.2023 të ankuesit, e në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 103 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *"1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës më numër A.nr.714/2023 të datës 08.05.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.714/2023, datë 17/05/2023

Avdyt BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;

